

Tema e doktoraturës: “Dygyhësia te shqiptarët në Malin e Zi”

Autori: mr. Haxhi Shabani

REZYMEJA:

Në temën e doktoraturës “Dygyhësia te shqiptarët në Malin e Zi” trajtohet dygyhësia si dukuri sociolinguistike, duke pasur për qëllim që të përshkruhen dhe analizohen përdorimet gjuhësore, përkatësisht situatat e ndryshme gjuhësore të folësve të cilët gjuhë bazë kanë gjuhën shqipe. Për të bërë studimin e kësaj dukurie gjuhësore, por edhe shoqërore siç është dygyhësia janë përdorur tri metoda kryesore pune: vëzhgimi individual i përdorimeve gjuhësore në terren, realizimi i anketave dhe i intervistave të cilat jo gjithnjë kanë dhënë përfundime të njëjta me vëzhgimin individual, duke pasur parasysh, kuptohet edhe përvojën e hulumtimit të dukurisë përkatëse në literaturën gjuhësore dhe të afërt me të.

Tema e doktoraturës ka për objekt studimi jo vetëm kontekstin e situatave të ndryshme gjuhësore të shqipes në Malin e Zi në kornizën kohore rreth 5 vjeçare (2009-2014), por edhe kontekstin shoqëror të folësve, duke u bazuar edhe në atë historik dhe demografik. Fillimisht janë marrë parasysh dhe janë përmbledhur zhvillimet historike dhe demografike kryesore të shqiptarëve që sot jetojnë në Malin e Zi. Shqiptarët që sot jetojnë në Malin e Zi historikisht kanë qenë pjesë integrale e zhvillimeve historike ilire-arbërore, për të përfunduar në kuadër të Malit të Zi, pa dëshirën e tyre, por me trysinë e Fuqive të Mëdha, në nëntor të vitit 1880. Në kuadër të politikave herë-herë edhe kundërshqiptare që ndaj tyre ka pasur Mali i Zi, shqiptarët e këtushëm janë zvogëluar numerikisht si rezultat i shpërnguljeve, por edhe asimilimit. Sot në Malin e Zi jetojnë rreth 40 - mijë shqiptarë, por numri më i madh i tyre në kuadër të kufijve të sotëm politik të Malit të Zi mund të ketë qenë dyfish më i madh.

Në Malin e Zi fliten të folme shqipe të dialektit të gegërishte veriperëndimore, duke u dalluar të folmet të cilat shikuar në përgjithësi në raport me njëra-tjetrin janë heterogjene, ruajnë elemente arkaike, kanë shkëputje me njëra-tjetrën, kanë pasuri leksikore që nga leksiku bujqësoro-blegtoral, por kanë edhe huazime të shumta leksikore, sidomos nga gjuha malazeze. Dygyhësia është vështrohet si një dukuri sociolinguistike që është karkarakteristike në mjediset ku

së paku dy gjuhë janë në kontaktë. Është dukuri e cila ka përfshirë shumë shtete dhe rajone dhe janë të pakta vendet në të cilat nuk është karakteristike, sado që mbetjet e mendësive njëgjuhësore janë ende me ndikim si në Evropë ashtu edhe në SHBA. Mali i Zi formalisht konsiderohet si mjedis shumëgjuhësor, por realisht, përjashto në disa vendbanime ku jetojnë shqiptarët në nivel vendor, funksionon si një shtet njëgjuhësor, pasi ngjashmëritë midis gjuhëve sllave të jugut: gjuhës malazeze, serbe, boshnjake dhe kroate janë të shumta, saqë në thelb kemi të bëjmë me një gjuhë. Për shqiptarët në Malin e Zi, dygjuhësia është historikisht e imponuar, por aktualisht ajo funksionon si një veçori e tyre që në shumicën e rasteve pranohet si një dukuri reale dhe funksionale.

Sipas studiuesve e ardhmja e gjuhëve në përgjithësi, bazuar në literaturën gjuhësore përkatëse është e paqartë. Ka të të atillë, si studiuesi anglez, Dejvid Krital i cili parashikon se anglishtja do të jetë një gjuhë që do të rrezikojë të tjerat, kurse të tjetër mendojnë se anglishtja nuk është rivale e gjuhëve të tjera, pasi ajo në shumicën e botës mësohet krahas gjuhës amtare. Gjuhëtari Kristal, në librin “Vdekja e gjuhëve”, trajton problemet e gjuhëve të cilat janë të rrezikuara, probleme të cilat në një pjesë të konsiderueshme korrepondojnë me statusin, pozitën, situatat dhe problemet që i ka shqipja në Malin e Zi, sidomos në variantin e saj të shkruar. Në variantin e shkruar gjuha shqipe në Malin e Zi ka probleme të theksuara, duke ia lëshuar vendin gjithnjë e më shumë gjuhës malazeze dhe duke marrë veçoritë e një gjuhe të rrezikuar. Në të njëjtën kohë trajtohet qëndrimi ndaj gjuhëve të pakicave në dokumentet ndërkombëtare ka gjetur një zgjidhje të pranueshme sidomos në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, por problemi është i pazgjidhshëm në nivelin e duhur sepse përdorimi i këtyre gjuhëve nuk zbatohet në praktikë. Një zgjidhje afërsisht e pranueshme është edhe në kuadër të Kushtetures së Malit të Zi, sipas së cilës shqipja është në përdorim zyrtar, por problemet shfaqen në ligjet përkatëse të cilët nuk sigurojnë përdorimin e saj bazuar në ligjin themelor, kurse përdorimi publik në praktikë është i nivelit të ulët, edhe nga shumica e vetë folësve shqiptarë.

Një vend të veçantë në këtë punim i kushtohet (mos) përdorimit të dygjuhësisë te shqiptarët në Malin e Zi që është i varur nga treva në të cilën flitet shqipja. Parimisht në trevat rurale, në të cilat jetojnë shqiptarët në Malin e Zi ekziston një njëgjuhësi stabile e shqipes, kurse gjuha tjetër është prezente në nivel të leksikut, ndërsa këmbimi i kodit bëhet në raste të veçanta, por dygjuhësia është dukuri edhe për shumicën e kësaj popullate duke pasur parasysh se ajo bën

jetë aktive edhe në zonat urbane. Në anën tjetër, shqiptarët që jetojnë në pjesët urbane apo gjysmurbane: në Ulqin e Tuz janë kryesisht përdorues të rregullt të dygjuhësisë në ambientet publike, kurse në Tivar, Plavë Guci e Rozhajë ata në jetën publike shqipen e përdorin vetëm në formë fragmentare. Kështu shqiptarët në Malin e Zi sa më i shumë që i largohen mjedisit familjar, përkatësisht përdorimit privat e intim të gjuhës shqipe, aq më pak e përdorin këtë gjuhë, duke e zëvendësuar me gjuhën malazeze. Në fushë të kulturës, arsimit e mediave, deri dikund, mund të thuhet edhe në fushë të politikës bëhet përdorimi i gjuhës shqipe, e cila shumicën e rasteve del krahas gjuhës malazeze, por në fushë të ekonomisë, tregtisë, gjykatave që ka të bëjnë me përdorimin e gjuhëve me shkrim, shqipja përdoret pak ose aspak.

Në këtë temë janë parë edhe përdorimet e veçanta të gjuhës bazë dhe gjuhës së dytë. Te shqiptarët në Malin e Zi, shqipfolësit të cilët krijojnë marrëdhënie martesore me një folës të një gjuhe tjetër, shumica e komunikimit të tyre zakonisht zhvillohet në gjuhën tjetër (jo në gjuhën shqipe), përjashtoj raste të rralla. Fëmijët e këtyre çfiteve, po ashtu në shumicën e rasteve fillimisht mësojnë gjuhën tjetër, pa marrë parasysh se cila është gjuha e nënës, por shumica nga ata, në të njëjtën kohë, mësojnë edhe gjuhën shqipe, më së largti deri në moshën e rinisë. Ndërkaq, përkatësia fetare te shqiptarët në Malin e Zi nuk përcakton ruajtjen apo jo të gjuhës amtare, apo gjuhës së të parëve. Është e njohur prirja se shqiptarët e fesë katolike në komunën e Ulqinit janë më pak të prirur të ruajnë shqipen, sidomos kjo është karakteristike për shqiptarët në Tivar. Por, në Tuz ndodh dukuria tjetër, janë pikërisht shqiptarët e fesë islame, me përjashtime, të cilët kanë prirje për të humbur gjuhën shqipe. Të dyja këto dukuri, reflektohen edhe në emrat e përveçëm të njerëzve.

Aspekti i përdorimit të dygjuhësisë në formë publike dhe me shkrim është funksional në nivel të pushteteve vendore në Ulqin dhe deri dikund edhe në Tuz, por nga institucionet qendrore të cilat shtrijnë veprimtarinë e tyre edhe në mjediset shqiptare të përmendura është më i pakët. Por, edhe në këto mjedise gjuha shqipe në formë të shkruar nuk del si gjuhë origjinale, po është e përkthyer nga gjuha malazeze. Kurse në nivel të institucioneve qendrore gjuha shqipe ka përdorim fragmentar.

Fjalët kyçe: dygjuhësi, gjuhë shqipe, gjuhë malazeze, këmbimi i kodit, shqiptarët në Malin e Zi.